




Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSh. Nr. 773/22

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje nga Isa Hasani – Kryetar, pas shqyrtimit të kërkesës së ushtruar nga komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), Numër Protokolli 773/2022, për diskualifikim të Operatorit Ekonomik (OE) Profitech SH.P.K., Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje për praktikë profesionale në stomatologji dhe pajisje për pastrim në shkollën Hysni Zajmi", me numër identifikues: 632-22-8070-1-2-1, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës dhe nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP Nr. 01/2020 (e amendamentuar) me datë 15.11.2023, mori:

V E N D I M

1. Refuzohet, si e pa bazuar kërkesa e datës 19.09.2022, e Komuna e Gjakovës, nga cilësia e Autoritetit Kontraktues (AK), për diskualifikim të OE Profitech SH.P.K., Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje për praktikë profesionale në stomatologji dhe pajisje për pastrim në shkollën Hysni Zajmi", me numër identifikues: 632-22-8070-1-2-1.

A r s y e t i m

Me 19.09.2022, KK Gjakove, në cilësinë e AK ka dorëzuar në OSHP kërkesë për diskualifikim të OE Profitech SH.P.K., Prishtinë, me numër unik 810081646, konform nenit 99, paragrafi 2 të LPP. Lidhur me këtë, OSHP me 26.09.2022, ka autorizuar udhëheqin e divizionit të shqyrtimit të ankesave për të përgatitur një kronologji për kërkesën e lartcekur.

Gjatë analizimit të shkresave të kësaj lënde konstatohet, se Komisionit të Vlerësimit të AK (KK Gjakovë), OE ka plotësuar të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si në hyrje të këtij Vendimi, prandaj dhe Zyra e Prokurimit e AK, me 08.09.2022, ka kërkuar nga OE që ti sjellë dokumentet e pranueshmerisë në mënyrë që të publikohet Vendimi i AK lidhur me dhënien e kontratës. Dokumentet e pranueshmerisë në këtë rast nënkuptojnë: a) Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe b) Vërtetimin nga Gjykata dhe c) Sigurimin e tenderit.

OE në fjalë, brenda afatit të kërkuar ligjor, nuk ka dorëzuar vërtetimin nga ATK se nuk ka obligime-borxhe të tatimeve në ATK, vërtetimin e lëshuar nga një Gjykatë kompetente se kompania (biznesi) nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë si dhe Sigurimin e tenderit.

KK Gjakove, në përputhje me nenin 26.8: Ka vazhduar me tërësinë e listuar në vendin e dytë; Me këtë kërkesë inicion procedurën për diskualifikim të OE, ku AK KK Gjakove, kërkon nga OSHP zbatimin e nenit 99.2 për arsye se OE ka paraqitur të dhëna të rreme me rastin e dorëzimit të ofertës me datë 31.08.2022, kurse bashku me oferte ka dorëzuar Deklaratën në Betim në të cilën deklaronte OE deklaron se i përmbush kushtet e përshtatshmërisë, respektivisht nenin 65 të LPP.

Pas pranimit të kërkesës për diskualifikim nga AK, OSHP i ka dërguar shkresë (e-mail) OE me 19.09.2022, duke kërkuar që i njëjti ta informoj OSHP lidhur me të gjitha informacionet relevante lidhur me çështjen në rastin konkret.

Me 19.09.2022, OE ka dorëzuar në OSHP një Përgjigje përkritazi me kërkesën e AK për diskualifikim, duke shpjeguar se ato dite ka pasur probleme me sistemin e-prokurimi dhe se të njëjtit nuk e kanë vërejtur emailin e dërguar nga AK.

OSHP ka verifikuar sistemin e e-prokurimit dhe në këtë web faqe është vërejtur se KRPP ka lëshuar një Njoftim në të cilin citohet se “Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) njofton të gjithë Operatorët Ekonomik, Autoritetet Kontraktues dhe OSHP se njoftimet e datës 05.09.2022, 06.09.2022 dhe 08.09.2022 rreth problemeve teknike me internet qeveritar, aplikohen proporcionalisht edhe për rastet e përgatitjes dhe dorëzimit të “Kërkesave për Rishqyrtim” në AK dhe “Ankesave” në OSHP.

Duke ju referuar kërkesës së cituar si më sipër të AK, dhe njëherësh Përgjigjes së OE me shpjegimet e theksuara shkurtimisht si më sipër, dhe Njoftimit të KRPP-së, OSHP konsideroi se shkresat e kësaj lënde janë të mjaftueshme për vendosur në mënyrë meritore për këtë lëndë dhe se sipas provave në dispozicion nuk ishte e nevojshme të mbahet seanca dëgjimore me palë. Në kontesktin e gjitha shkresave të kësaj lënde dhe veprimeve të ndërmarrur nga të dyja palët (AK dhe OE), Paneli konsideron shkaqet e mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e OE paraqesin justifikim nga fakti se KRPP ka njoftuar të gjitha AK dhe OSHP-në se në datat 05.09.2022, 06.09.2022 dhe 08.09.2022, e-prokurimi ka pasur probleme teknike që ju ka pamundësuar palëve të kenë qasje të plote në e-prokurim, konsiderojmë se këto probleme teknike i kanë pamundësuar edhe OE të shoh kërkesën e AK-së për dokumentet e kërkuar. Kjo nga fakti se në përgjigje OE në fjale i ka bashkangjitur dëshmitë e kërkuar dhe se këto dëshmi nuk janë kontestuar me pas nga palët në procedurë.


Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi konstaton se autoriteti kontraktues – KK Gjakovë, nuk ka arritur të argumentoj se dorëzuar asnjë provë se OE “Profitech SH.P.K., Prishtinë në këtë aktivitet të prokurimit, ka mashtruar apo ka falsifikuar ndonjë dokument apo dëshmi, për të cilën edhe OSHP, mund të merr masa konkrete ndaj ndonjë operatori ekonomik.

Paneli shqyrtues është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, nuk ka arritur të ofroj ndonjë dëshmi apo prove për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e Profitech SH.P.K., Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje për praktikë profesionale në stomatologji dhe pajisje për pastrim në shkollën Hysni Zajmi”, me numër identifikues: 632-22-8070-1-2-1.

Përveç të tjerash, është fakt i njohur botërisht ngritja e çmimeve në materiale, shërbime, furnizime, gjithashtu lidhur me rastin konkret, PSH merr parasysh që OE konkret gjithashtu ka ofruar dëshmi lidhur me këto ngritje të çmimit, në ofertat e furnizimit të dorëzuara.

Prandaj bazuar në të lartëcekurat dhe në bazë të nenit 99 par 2 të LPP-së, Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryesues i Panelit të Shqyrtues
Isa Hasani



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës kompetente me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Gjakoves

1x1 OE Profitech SH.P.K., Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së